

Urdhër nr. 577, datë 14.10.2020 “Për një ndryshim dhe shtesë në urdhrin nr. 266/1, datë 1.9.2020, për marrjen e masave të veçanta nga komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga covid-19”

Në mbështetje të nenit 116, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri”, si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, ky urdhër riformulon pikën 2 të urdhrin nr. 266/1, datë 01.09.2020, i ndryshuar, si vijon: “2. Tejkalmi i afateve të vlerësimit/rivlerësimit të aftësisë së kufizuar, gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, të përcaktuar në vendimin nr. 182, datë 26.2.2020, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, të ndryshuar, nuk përbën shkak për ndërprerjen e pagesave të aftësisë së kufizuar”, për përfituesit të cilëve iu ka përfunduar afati i përfitimit sipas vendimit të komisionit. Trajtimi me pagesë bëhet deri në momentin e rikomisionimit të tyre”.

Pas pikës 7, të urdhrin nr. 266/1, datë 1.9.2020, të ndryshuar, shtohen pikat 7.1 dhe 7.2 me këtë përmbajtje: “7.1 Përjashtimisht, gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 paraqitja e personave në komisionin e nivelit të parë, sipas pikave 1.1 dhe 1.2, të kreut II, të vendimit nr. 182, datë 26.2.2020, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, të ndryshuar, pikave 2.1 dhe 2.2, të udhëzimit nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar, realizohet me komisionin, personalisht përmes platformave *online* dhe në prani të përfaqësuesit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (mjek), në vendbanimin e personit. 7.2 Paraqitja në KMCAP-në eprore bëhet me prezencën fizike të personit. Vetëm në raste të veçanta, kur gjendja shëndetësore e rënduar është e argumentuar nga mjeku specialist përkatës, së bashku me arsyen e pamundësisë së paraqitjes në komision, si edhe kur KMCAP-ja eprore gjykon që paraqitja fizike është e pamundur, procedura e vlerësimit bëhet përmes platformave *online*, në prezencë të përfaqësuesit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (mjek) ose me prezencën e anëtarit/ve të komisionit epror, në vendbanimin e personit.”.

Urdhërin e gjeni në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/10/14/577/97523012-d402-440f-9f90-dc3941d7d10c>